



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 36, datë 04.02.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SH.P.K., PËR  
SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 89, DATË 06.08.2008, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5 dhe 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 04.02.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 20/8 Prot, datë 03.02.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 89, datë 06.08.2008, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike si dhe prodhimin e energjisë elektrike (Bllok motore-gjeneratore të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë, me kusht zbatimin përveç sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:
  - a. Shoqëria duhet të paraqesë pranë ERE-s opionencën tekniko- ekonomike nga ekspertë të licencuar brenda 60 ditëve nga lëshimi i licencës.
  - b. Shoqëria “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k. duhet të paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuar detyrimet e ndërsjellta, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.
  - c. Shoqëria “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., do të respektojë detyrimet e Shërbimit Publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
  - d. Koha e zbatimit e të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke ju referuar datës së lëshimit të licencës, të jetë 36 muaj.
  - e. Mospërmbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

## 2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

- Në vijim, me vendimet përkatëse, Bordi i ERE-s ka miratuar shtyrjet e afateve të plotësimit të kushteve të sipërcituara në Vendimin nr. 89/2008, i ndryshuar.
- Së fundi, Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 250, datë 21.12.2020, vendosi të shtyjë me 30 ditë afatin e vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 90, datë 06.08.2008, i ndryshuar, me qëllim verifikimin e plotë të dosjes të dokumentacionit të depozituar në ERE, në kuadër të kërkesës së shoqërisë për shtyrje të afateve të plotësimit të kushteve, si dhe dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria në kuadër të monitorimit, për të vlerësuar statusin e plotësimit të kushteve të këtij vendimi.
- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga shoqëria dhe duke u mbështetur tek përfundimet e monitorimit, ka rezultuar se nga ana e shoqërisë kanë mbetur ende pa u plotësuar disa kushte të vendimit nr. 89/2008, i ndryshuar.
- MIE me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.07.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj si vijon: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7/2017 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme" dhe të Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike". Të njëjtin qëndrim MIE ka mbajtur edhe në takimin e datës 03.02.2021, të zhvilluar mes përfaqësuesve të MIE-s, BERZH-it dhe ERE-s, duke theksuar se nuk duhet të zgjaten afatet e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit të këtyre subjekteve, pasi kjo mund të binte në kundërshtim me strategjinë e MIE-s për zhvillimin e procedurave konkurruese për ndërtimin e këtyre objekteve gjeneruese të cilët kanë mundësinë e marrjes pjesë në ankandin që do të zhvillohet.
- Në kuadër të projektit të asistencës që MIE ka marrë nga BERZH-i për ndërtimin e parqeve eolike është përcjellë një MEMO mbi statusin ligjor të licencave ekzistuese për prodhimin e energjisë e elektrike nga era dhe revokimin e mundshëm të tyre, si dhe një studim mbi zonat potenciale për ndërtimin e këtyre parqeve eolike dhe zonat në të cilat, për shkak të statusit të tyre, nuk mund të ndërtohen parqe të tilla.
- Sipas projektit të asistencës që MIE ka marrë nga BERZH-i, rezulton se një pjesë e mirë e turbinave (gati 1/3) të shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., që përfshijnë zonat e Balldrenit, Dajcit dhe Bushatiti, kalojnë në zona historike si dhe pranë aeroportit. Po ashtu turbinat në zonën e Balldrenit të Rid dhe Shëngjinit kalojnë tërësisht në zona të mbrojtura;
- MIE ka publikuar njoftimin për hapjen e ankandit të kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet linkut [Shprehje Interesi - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë \(infrastruktura.gov.al\)](http://www.ere.gov.al).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

## **Vendosi:**

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 89, datë 06.08.2008, i ndryshuar.
2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., nr. 63, seria NPM08P.
3. Shoqëria “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkoet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**